

VENDIM
Nr.392, datë 8.4.2008

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.1, DATË 10.1.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PROKURIMIN PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin “Rregullat për prokurimin publik”, që i bashkëlidhet vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I “Organizimi i prokurimit publik”, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fund të shkronjës “d” të pikës 2 “Prokurimi i përqendruar dhe organi qendror blerës”, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Nëse autoriteti kontraktor, në përcaktimin e të dhënave sasiore, ka marrë për bazë çmime të ndryshme, që nuk u afrohen atyre të tregut, organi qendror blerës mund të krijojë një grup pune të përbashkët, me përfaqësues të autoritetit, i cili bën testimin e tregut dhe përllëgarit të dhënave sasiore, sipas fondit të vënë në dispozicion.”.

b) Në pikën 3 “Botimi i njoftimeve të kontratës”, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

i) Fjalja e tretë e shkronjës “c” shfuqizohet dhe zëvendësohet me “Afati i fundit i pranimit të njoftimit është deri në 5 ditë përpara publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, pasardhës. Ky afat nuk do të zbatohet në rastet kur hedhja e njoftimit në sistem bëhet nga vetë autoritetet kontraktore, sipas udhëzimeve të APP-së.”.

ii) Fjalja e fundit e paragrafit të parë të shkronjës “ç” shfuqizohet dhe zëvendësohet me “Afati i fundit i pranimit të njoftimit për publikim është deri në 5 ditë përpara publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, pasardhës. Ky afat nuk do të zbatohet në rastet kur hedhja e njoftimit në sistem bëhet nga vetë autoritetet kontraktore, sipas udhëzimeve të APP-së.”.

2. Në pikën 2 të kreut III, “Dokumentet e tenderit” bëhen shtesat e mëposhtme:

c) Në shkronjën “e”, pas fjalisë së parë të paragrafit të dytë, shtohet fjalja, me këtë përmbajtje:

“Në rastet e procedurave të prokurimit për blerjen e energjisë elektrike, ofertuesit duhet të paraqesin sigurimin e ofertës, në vlerën 2 për qind të ofertës së paraqitur në këto procedura prokurimi.”.

b) Në shkronjën “ë”, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Në procedurat e prokurimit për blerjen e energjisë elektrike, në rast se kontraktori nuk lëvront plotësisht/pjesërisht sasinë e kontraktuar, autoriteti kontraktor konfiskon, nga vlera e sigurimit të kontratës, vlerën për sasinë e energjisë elektrike të palëvruar, e cila llogaritet si diferencë e çmimit më të lartë, për të cilin autoriteti kontraktor ka ose do të ketë mundësi ta blejë energjinë elektrike të palëvruar. Vlerës së mësipërme duhet t’i nënshtrohen edhe kostot e mundshme për sigurimin e rrugëve të transmetimit, si dhe kostot e tjera përkatëse, të dokumentuara. Në këtë rast, kur vlera e sigurimit të kontratës është më e vogël se vlera që autoriteti kontraktor duhet të konfiskojë, diferenca mbahet nga vlera e pagesës, që autoriteti kontraktor do t’i paguajë kontraktuesit për sasinë e energjisë elektrike të lëvruar.”.

3. Në pikën 3 “Kohëzgjatja e kontratës” të kreut VII “Kushte të përgjithshme për zbatim”, bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në shkronjën “a”, pas fjalëve “... me shkronjën “b”...” shtohen fjalët “... të pikave 3 e 5...”.

b) Në shkronjën “b” shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Objekti i tyre është mirëmbajtja e mjeteve kompjuterike apo mirëmbajtja e sistemeve elektronike/kompjuterike, me shtrirje gjeografike dhe/ose institucionale, që bën të nevojshëm zhvillimin e kapaciteteve njerëzore, ngritjen e ekspertizës dhe/ose të infrastrukturës. Këtu, gjithashtu, përfshihen edhe kontratat e shërbimit të ndërlidhjes (konjektivitetit) në shumë pika, në rastet kur kanë tarifë fillestare instalimi. Kohëzgjatja e këtyre kontratave nuk duhet të kalojë 4 vjet.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha